

DEPARTAMENTI PËR FINANCA, EKONOMI DHE NDRËRMARRJE PRIVATE

Departamenti në sferën e finansave kryen aktivitete në lidhje me ekonomin dhe egzekutimin e buxhetit të komunës: të ardhurat lokale publike dhe shpenzimet, menaxhimi i investimeve të cilat finansohen nga buxheti, huamarrja e komunës, thirrje për kredi dhe planifikimi i mjeteve, inspektimin dhe mbikqyrje mbi shfrytëzimin e mjeteve nga buxheti dhe ndikimi i sistemit fiskal dhe sistemit të finansimit të shpenzimeve publike në ekonomin e komunës.

Në sferën e ekonomis kryen punët të cilat kanë të bëjnë me përmbushjen e disa nevojave të qytetarve në sferën e shëndetit, turizmit, hotelijeri dhe tjera sferave që janë në interes të komunës, qmimet e shërbimeve publike dhe tjera sferave të cilat janë në jurisdikcionin e komunës.

Departamenti kryen dhe punët e Qeverisjes shtetërore në fushën e bujqësis, mbrojtjen dhe shfrytëzimi dhe promovimin e tokës bujqësore, pyjeve dhe ujërave, bimëve dhe kafshëve, inxhinjerin e ujit, industrin, veprat artizanale, ndërmarrjet private, tregtinë, furnizimin e tregut, zhvillimin ekonomik, turizmin dhe tjera fushave të cilat Republika ija beson komunës.

Departamenti kryen punët të cilat janë për përcaktimin, mbledhjen dhe kontrollimin e të ardhurave lokale publike dhe kujdeset për të drejtat dhe obligimet e tatimpaguesve. Kryen kontrollimin në teren dhe zyra për kontrollin dhe verifikimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së plotsimit të detyrimeve tatimore.

Kryen mbledhjen e të ardhurave publike lokale, të rregullta dhe të detyruara dhe udhëheq kontabilitetin tatimor. Ofron ndihmë profesionale dhe ligjore tatimpaguesve mbi bazën e të ardhërave publike lokale. Lëshon certifikata për faktet për të cilat mban evidencen zyrtare.

Departamenti përcjell zhvillimin dhe merr pjesë në punimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës. Kryen punë profesionale, administrative dhe teknike në menaxhimin, koordinimin dhe aktivitetet në fushën e zhvillimit ekonomik lokal. Kryen punët të cilat referohen në marketing, promovim në veb faqet dhe paraqitjet publike, edukim në përputhje me nevojat e subjekteve ekonomike dhe shërbimeve publike në mënyrë që të mbështetet zhvillimi ekonomik i komunës.

Organizimi i brendshëm i departamentit:

Departamenti i kontabilitetit, në të cilit gjenden referatet vijuese:

- shefi i kontabilitetit
- referenti për ekonomi të vogël,
- referenti për plan, analizë, rezervat e mallërave, statistik dhe mbrojtje kombëtare të përgjithshme,
- referenti për zbatimin e buxhetit dhe të fondeve,
- arkatari dhe kontabilisti,
- referenti për punët e thesarit,
- referent për kontrollin buxhetor dhe auditim,
- departamenti për administratën lokale tatimore,
- shefi i Departamentit të administrates lokale tatimore.

Kontakti:

Tel: 016 891-153 lokali 9

e-adresa: z.dimic@medvedja.org.rs